



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 29.07.2019

Ref.: 1368/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

I. Nuk riakreditohet BPRAL "Kosovo Art Academy" në nivel institucional;

II. Nuk riakreditohen programet e studimit të "Kosovo Art Academy":

- Dizajn, BA, 180 ECTS;
- Dizajni Grafik & Multimedia, BA, 180 ECTS;
- Fotografi, BA, 180 ECTS.

Arsyetimi

BPrAL "Kosovo Art Academy" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për Akreditim institucional dhe të programeve të studimit:

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL "Kosovo Art Academy" me 29.05.2019, me qëllim të vlerësimit të institucionit dhe të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, me këtë përbërje: Prof. Stephan Adam, Prof. Alan Brickwood dhe znj. Oana Sarbu.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19 qershor 2019 dhe 15 korrik 2019 ka shqyrtuar raportin final të ekspertëve ndërkombëtar për BPrAL "Kosovo Art Academy", dhe pas shqyrtimit të rekomandimeve përfundimtare, të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket kapitullit të parë për deklaratën e misionit dhe objektivat institucionale, deklarata e misionit promovon stilin e artit Italian dhe Evropian duke përjashtuar të tjerat. Nuk është i përqendruar në rëndësinë e stilit artistik dhe trashëgimisë së pasur kulturore të Kosovës dhe Ballkanit. Deklarata aktuale e misionit nuk e vënë në vendin e merituar artin global joevropian i cili nuk duhet të përjashtohet si i parëndësishëm. Deklarata e misionit qartësisht reflekton qasjen e themeluesit amë 'Academy Free of Fine Arts (LABA)'. Nuk ka dëshmi se deklarata e misionit është definuar ose rishikuar në konsultim me bashkëpunëtorët e brendshëm, bashkëpunëtorët e jashtëm, lokal ose regional. "Zhvillimin strategjik dhe Plani i Sigurimit të Cilësisë" 2018 në RVV, tregon të ketë variacione të deklaratës së misionit dhe vizionit, vetëm një deklaratë e misionit duhet të ekzistoj. Objektivat dhe objektivat kryesore të institucionit nuk janë të paraqitura në termat afat-mesme dhe afat-gjate. Ngjajshëm dokumenti i zhvillimit strategjik ka datën 2018 mirëpo nuk e ka datën e periudhës përfunduese.

Sa i përket kapitullit për planifikim strategjik, "Zhvillimin Strategjik dhe Plani i Sigurimit të Cilësisë 2018" vë në pah mangësi të shumta. Është e pazakontë të përmbledhësh 'zhvillim strategjik' me 'sigurimin e cilësisë'. Dokumenti ka shumë qëllime dhe aspirata por po ashtu edhe defekte të konsiderueshme dhe i nuk i përfshinë: implikimet e hollësishëm të burimeve me kosto të ndërlidhura; implikimet për buxhetin financiar të institucionit; identifikimi i individëve ose komiteteve përgjegjëse për implementim; mekanizmat vlerësues dhe monitorimin e progresit (afat-mesëm dhe afat-shkurtër), kriteret për vlerësim etj. Dokumenti vetëm tregon se menaxhmenti: "do të shqyrtojë dhe vlerësojë parimet dhe zbatimin e strategjisë në baza të rregullta dhe do të ndërmarrë veprime përmirësuese nëse është e nevojshme". Strategjia nuk shihet të jetë reflektuar në informata të buxhetit. Organogrami tregon paqartësi gjë që e bënë gjendjen edhe më konfuze ku për pozita të njejta, ka tituj të shumëfishtë.

Çështjet tjera si dimensionin vendim marrës akademik dhe administrativ qëndrojnë në dy diagrame të ndara dhe sugjeron që nuk ka lidhje në mes të tyre; Drejtori duket të lidhë të dy pozitat mirëpo ato janë pozita për dy drejtori të ndryshme; Sugjerohet që Senati Akademik kyqet drejtpërsëdrejti në bord/këshillin drejtues; Drejtori (akademik) i filtron çdo gjë që shkon në Senat nga Këshilli dhe departamente të ndryshme; Sipas organogramit bartësit e programit të Fotografisë dhe Dizajnit duhet të shkojnë përmes Departamentit të Dizajnit Grafikë dhe Multimedias; Këshilli politikbërës akademik është këshill i Senatit mirëpo i raporton Drejtorit dhe jo drejtpërdrejt Senatit; Këshilli politikbërës akademik kërkon propozime nga zyrja e cilësisë dhe ECTS-s të cilat raportojnë nëpërmjet katër niveleve ndërhyrëse të këshillave/organeve/ departamenteve; Roli, funksioni dhe termat e referencës e Këshillit Shkencorë mësimdhënës dhe Këshillit të departamenteve nuk janë të shpjeguara në RVV; Këshilli Përfaqësues i Studentëve nuk është fare i paraqitur në organogram. Zyrja për Financa, Marrëdhënie njerëzore dhe marrëdhënie ndërkombëtare po ashtu nuk janë të paraqitura në organogram. Ngatërrimi i titujve në organogram dhe përgjegjësi bëjnë një strukturë tejet komplekse për një institucion të vogël, i cili nuk reflekton një lidhje të duhur dhe reale. Për më tepër duhet të ceket dhe qartësohet lidhja me Academy Free of Fine Arts (LABA).

Në RVV Këshilli Përfaqësues i Studentëve paraqitet të ketë të drejta të jashtëzakonshme në: '... do të shprehë mendime të detyrueshme për propozimet që lidhen me: a) programet e zhvillimit të Akademisë; b) rregulloret didaktike; Intervenimet në lidhje me të drejtën për të studiuar '.

Në statusin e Akademisë e gjitha fuqia i ipet Bordit të Drejtorëve. Çështjet që lidhen me statutin përfshijnë: neni 7 (6) - themeluesit duket se kanë përgjegjësinë përfundimtare për të kundërshtuar çdo gjë që ata duan duke përfshirë: "do të kenë autoritetin për të refuzuar ose ndryshuar ndonjë akt të Drejtimit Këshilli, Senati, Drejtori ose ndonjë zyrtarë ose organ tjetër i Akademisë që nuk është në përputhje me Statutin, Ligjin për Arsimin e Lartë ose me autorizim ".

Sa i përket integritetit akademik, Institucioni ka adaptuar Kodin e Etikës i cili ka për qëllim themelimin e rregullave për sjellje profesionale të stafit akademik si dhe atë administrativë të Art Academy. Kodi etikë është shumë i përgjithshëm pa ndonjë proces ose mekanizëm specifik të zbatueshëm i cili do të sanksiononte shkeljet eventuale të dispozitave të kodit. Për këtë nuk ka ndonjë dëshmi se institucioni është duke e zbatuar kodin e etikës. Askund në kod nuk është cekur çështja e plagjiarizmit. Dokumenti i quajtur Kod i Etikës është më shumë një tërsi e rregullave dhe vlerave që duhet respektuar nga ana punëtorëve dhe është i publikuar në ueb faqën e institucionit. Kosovo Art Academy nuk ka strukturë siç do të ishte një Këshill Etik përgjegjës për mekanizimin dhe zgjedhjen e ndonjë shkelje të mundshme të kodit të etikës. Gjatë vizitës së institucionit ekipi i ekspertëve ka vërejtur se komuniteti akademik nuk është i njoftuar me përmbajtjen e kodit të etikës dhe nuk kanë mundur ti adresojnë as pyetjet më të përgjithshme. Ekipi i ekspertëve nuk ka identifikuar: rregullore relevante ose procedurë sikurse strategji, procedurat mbi sigurimin e cilësisë, kodi i etikës në ueb të akademisë. Në përgjithësi nuk ka informata të mjaftueshme për stafin akademik, hulumtim, aktivitete akademike, programe që ofrohen, numri i studentëve të pranuar, rezultatet e synuara të programit të studimit, kualifikimi i cili ipet me përfundim të programit, mësimdhënia, mësimnxënia dhe procedura e vlerësimit, shkalla e kalueshmërisë dhe mundësia e mësimnxënies në dispozicion për studenta, informata mbi punësimin e të diplomuarve, mundësia e fitimit të bursës, si dhe pagesat administrative dhe të shkollimit.

Sa i përket menaxhimi i cilësisë, institucioni ka zhvilluar 'Planin për zhvillim strategjik dhe sigurim të cilësisë 2018 dhe dokumentin e quajtur Politikat dhe procedurat për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë 2017. Ekipi i ekspertëve ka identifikuar se ka keqkuptim të madhë në konceptin e sigurimit të cilësisë dhe kulturën e cilësisë përbrenda komunitetit akademik, stafit administrativë, dhe nga përgjegjësit për sigurimin e cilësisë në akademi. Institucioni duhet të ngritë përpjekjet që të promovoj zhvillimin e kulturës së cilësisë si kuptim i përgjithshëm i vlerave të cilësisë, për të cilën çdo punonjës i institucionit është përgjegjës, si ekip me ide të përbashkëta.

Sipas dokumentit politikat dhe procedurat për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë 2017 dhe RVVs në akademi funksionojnë zyra për sigurimin e cilësisë dhe komisioni qendror i vlerësimit. Gjatë vizitës ekipi i ekspertëve e ka kuptuar se ky komision nuk është themeluar ndërsa zyra e sigurimit të cilësisë ka të bëjë më shumë me cilësinë e menaxhimit se sa me sigurimin e cilësisë. Menaxhmenti i institucionit nuk duket i vetëdijshëm mbi rendësin e funksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, dështimi për ti përmbush kërkesat minimale të cilësisë gjatë gjithë kohe arsyetohet se është institucioni i ri. Nuk është identifikuar ndonjë mekanizëm të monitoroj implementimin a ashtuquajturës Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e cila i referohet Standardeve dhe Udhëzuesve Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG) është gjetur pak dëshmi mbi përdorimin e këtyre

standardeve. Aktivitetet e ofruara qëndrore për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe mësim nxënies nuk kanë qenë prioritet. Ekipi i ekspertëve ka përshtypje se kultura e cilësisë në Akademi është e bazuar në lidhje dhe rrjete joformale. Institucioni nuk ka ne dispozicion trajnime mbi mësimdhënësit mbi pedagogji, sigurim të cilësisë dhe se si këto ndërthurën në arsim, në hulumtim, procedurat e menaxhimit të akademisë. Sigurimi i cilësisë nuk është i integruar në ciklin e planifikimit, implementimit, vlerësimit dhe rishikimit.

Nuk ka sistem të integruar të menaxhimit e të dhënave ose një sistem i integruar i administrativ, të dhënat statistikore nuk mund të gjinden në një bazë të dhënash qëndrore të qasshme për përdorimin e saj në përgatitjen e raporteve mbi treguesit dhe detyrat e tjera në monitorimin e cilësisë. Në përgjithësi, nuk ka dëshmi të një sistemi funksional të sigurimit të brendshëm të cilësisë, nuk ka menaxhim sistematik cilësor në ndonjë komponent të institucionit - planifikimi strategjik, menaxhimi i burimeve njerëzore, programet e studimit, etj

Sa i përket mësimdhënies dhe mësimnxënies është cekur programet mësimore janë të ngjajshme me ato të LABA-s, akademia ka rregullore të përgjithshme didaktike 2017 e cila mbulon parimet e përgjithshme për ciklin e parë të studimeve, cilësinë e mësimdhënies, titujve akademik, çështjeve disiplinore. Është e dukshme se Akademia nuk e monitorin deri në çfarë mase këto politika dhe procedura janë zbatuar në mënyrë efektive. Rregullorja didaktike është në tri përmbledhje duke i mbuluar tri programe të studimit dhe nuk kanë ndonjë dallim në mes veti, këto nën rregullore duhet të kenë lidhshmëri me statut dhe rregulloret didaktike. Një përmbledhje e tillë duhet të ekzistoj edhe për institucionin i cili do të shërbente të jep një pasqyrë të qartë për të gjitha çështjet. Këto përmbledhje, rregullore të programeve përmbajnë pak detaje dhe fillojnë me informacionin mbi drejtimin kanë mangësi të informatave kryesore që i nevojitet studentëve: rregullat e avancimit; dështimi i moduleve kryesore; kriteret dhe mekanizmat e ankesave; rregullore për rrethana të veçanta; cili është maksimumi i zgjatjes së studimeve; klasifikimi i niveleve; në opsionet e dështimit/ modulet zgjedhore; njohja e mësimi paraprak; transferi i kredive; rregullat e punës në kurse; plagjiazmi; rregullat e punimit të diplomës; kriteret për matjen e pjesëmarrjes aktive; ankesat etj.

Në mungesë të funksionimit të komisionit qëndror të vlerësimit nuk duket të ketë sistem efektiv i cili do të siguronte se të gjitha programet e studimit plotësojnë standardet e larta të mësimdhënies dhe mësimnxënies, edhe pse programet rrjedhin nga LABA, Akademia duhet të ketë sistemin e brendshëm efektiv dhe procedurat për vlerësimin e standardeve të mësimdhënies dhe mësim nxënies.

Sipas ekipit të ekspertëve ndërkombëtar institucioni nuk ka qasje strategjike për të mbështetur stafin në procesin e hulumtimit/kërkimit, dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin hulumtues/kërkimor. Kodi i etikës aktual nuk ofron politika për plagjiazëm dhe pasuri intelektuale, nuk ka rregullore të qartë etike mbi aktivitetet e hulumtimit/ krijimin artistik. Nuk ka strukturë ekzistuese të siguroj ruajtjen e parimeve etike në hulumtim/krijimin artistik. Në statutin e institucionit ose në ndonjë rregullore të brendshme nuk ka dëshmi mbi vlerësimin periodik të stafit akademik, i vetmi instrument i aplikueshëm është pyetësori për studentë, mirëpo rezultate e pyetësorit nuk përdoren për analizë publike. Institucioni nuk ka zhvilluar politika/procedura që reflekton në instrument për vlerësimin e secilës kategori të stafit. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar vëren se edhe pse Akademia është në funksion tashmë gati dy vite ende nuk e ka zbatuar planin gjithëpërfshirës të trajnimit të stafit akademik, siç është paraparë në RVV ku thuhet se gjatë tri viteve të para të zhvillimit institucioni do të zbatoj planin e trajnimit dhe vizitave

studimore në Akademin LABA ku stafi akademik do të paisej me njohuri të reja akademike, përvojë në mësimdhënie dhe ofrimi i shërbimeve në fushën e edukimit. Stafit akademik nuk i është dhënë ndonjë mundësi për trajnim të vazhdueshëm në pedagogji, në sigurimin e cilësisë, dhe si janë të ndërlidhura në arsim dhe me hulumtim. Institucioni nuk ka doracakë për informim të studentëve dhe rregullore në rast të plagjiarizmit ose formave të tjera të kopjimit.

Librat, revistat dhe materialet tjera për mësim janë në numër të vogël, nuk ka zyrtarë për përkrahje të studentëve ose mësimdhënësve për regjistrim, marrje dhe kthim të librave.

Kosovo Art Academy duhet të kuptojnë se një institucion i arsimit të lartë duhet të sigurojë efikasitetin e cilësisë së menaxhimit dhe sistemeve të sigurimit të cilësisë.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar konstatoi se institucioni nuk ka ndonjë strategji për rregullimin çështjeve të nërkombëtare të institucionit, dhe të identifikoj ndonjë objektive strategjike për periudhën në planifikim. Nuk ka mundur të konstatoj se si Kosovo Art Academy matë arritshmërin. Mungesa e objektivave të përcaktuara qartë të arritjes, të shoqëruara me indikator matës, në çështjet si mobiliteti, lidhjet ndërkombëtare të hulumtimit të cilat mund të shërbejnë si pikë referuese për planifikim në këtë fushë për institucionin. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar konstaton se ky është një lëshim, institucioni nuk ka metodë të qartë për ta vlerësuar dhe monitoruar progresin.

Programi i studimit: Dizajn BA

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar konstaton se deklarata e misionit është e njëjtë për tri programe të studimit dhe është zhgënjyes me që mund të përdoret për të përshkruar gati secilin program të dizajnit kudo në botë. Nuk ka ndonjë artikullim të veçantë se çfarë një ndërmarrësi premtuese me LABA mund ti ofroj Kosovës. Nuk ka shpjegim se çka nënkupton me stil 'Italian dhe Evropian' dhe çka mund të rezultojë nga ajo që më herët është përmbledhë si çasje e "arteve të bukura" ku mbizotëron pasioni për estetikë dhe kreativitet. Gjatë përcaktimit të rezultateve të mësim nxënies, nuk ka dëshmi se institucioni është konsultuar me industrinë, punëdhënësin, palët e interesit, këshillë e dhënë në raportet e vlerësimit ndërkombëtar nga vitet e kaluara e cila nuk është marrë parasysh. Nuk ka informata të mjaftueshme të publikuara për stafin akademik, hulumtim dhe aktivitete akademike, programe të ofruara, numri i studentëve të pranuar, rezultatet e synuara e të nxënies të programeve, kualifikimet që ata i japin, mësimdhënia, mësimnxënies dhe procedura të përdorura të vlerësimit, normat e kalueshmërisë dhe mundësitë e të nxënies në dispozicion të studentëve, informatat mbi punësim të diplomuarve, mundësitë e bursave, si dhe pagesat për shkollim dhe administratë.

Janë të paplotë dhe të pa evidentuara çështjet si: mbi atë që mund të ndodhë nëse një student dështon, nuk ka kufij të referimit, dallimin ndërmjet studimeve 'kryesore' dhe 'elementëve të studimit mbështetës për të mbrojtur integritetin e programit të studimit, vlerësimin e notimit, e drejta e ankesës, ankesat dhe zgjidhja e tyre. Nuk ka ndonjë referim ose doracak për studentët se ku mund ta gjejnë këto informatë. Kodi etik i adaptuar me qëllim të themelimit të rregullave për sjellje profesionale për anëtarët e stafit akademik dhe administrativ, është shumë i përgjithshëm pa ndonjë mekanizëm specifik për të aplikuar sanksionet në rast të thyerjes së kodit. Për këtë nuk ka ndonjë dëshmi se institucioni është duke e

aplikuar kodin dhe në kod nuk përmendet çështja e plagjiaturës. Kodi i adresohet stafit të Akademisë dhe jo studentëve si dhe nuk është i publikuar në ueb faqe të institucionit.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë konstaton se ka keqkuptim të madh mbi konceptin e sigurimit të cilësisë ose kulturës së cilësisë brenda komunitetit akademik dhe stafit administrativ, madje edhe për ata që janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë në akademi. Funksionet e sigurimit të cilësisë nuk janë të integruar në një cikël të përcaktuar të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe rishikimit. Nuk ka dëshmi nëse të dhënat e fituara nga vlerësimi nga ana e studentëve është sistematike dhe përdoren me të vërtetë për ndryshime ose për të zhvilluar një raport vjetor për sigurimin e cilësisë.

Kultura e cilësisë dhe sistemet e sigurimit të cilësisë nuk janë të përfshira në proceset e institucionit. Analiza SWOT identifikon dobësi në përvojën e stafit në aplikim të teknologjisë bashkëkohore në programe dhe mungesa e resurseve për të filluar punën e re. Për të adresuar këto dobësi nuk është bërë alokimi buxhetor. Në statutin e institucionit ose në ndonjë rregullore të brendshme nuk ka dëshmi mbi vlerësimin periodik të stafit akademik, i vetmi instrument i aplikueshëm është pyetësori për studentë dhe diskutimi mbi rezultate, mirëpo rezultate e pyetësorit nuk përdoren për analizë publike dhe procesi nuk rezulton me ndonjë dokument.

Programi Dizajn është i gjerë dhe i cekët 'Dizajn', duke përfshirë lëndët zgjedhore, përfshin pesë fusha të ndryshme të studimit kryesor që variojnë nga grafika, eko, brendësia, produkti dhe moda - të cilat zakonisht mund të gjenden në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe përbëjnë vetëm një studim të specializuar. Grafika duket se e mbizotëron këtë program dhe kjo është gjithashtu e njëanshme në lëndët mbështetëse. Nuk ka gjasa që ndonjë student në këtë program të arrijë rezultate që në ndonjë mënyrë të çojnë në një specializim. Ekziston gjithashtu një gamë po aq e gjerë e lëndëve mbështetëse të cilat, supozohet, mund të përafrohen me lëndë kryesore për të ofruar zgjidhje. Një shembull mund të jetë "teknologjia e materialeve" lëndë zgjedhore, por kjo, siç mund të pritet, nuk adreson përbërjen e materialeve të përbashkëta si druri, metali, plastika, qeramika dhe pëlhura. Nuk ka asnjë përshkrim sa i përket rezultateve të mësimnxënies, dhe vlerësimit. Duket se nuk ka ndonjë rregullore të hollësishme lidhur me plagjiaturë ose forma të tjera të mashtrimit.

Rezultatet e përgjithshme vjetore të lëndëve nuk janë përpiluar në nivel institucional në raportin e përgjithshëm dhe nuk përdoren në analizën e rezultateve duke përfshirë trendet në kohë ose planet e veprimit. Aktualisht institucioni nuk ka planë të zhvillimi për hulumtim, dhe se stafi duhet vetë të angazhohet në kërkime shkencore dhe sidoqoftë, nuk ka ndonjë indikacion në planet e të ardhurave dhe shpenzimeve të Akademisë gjatë tre viteve të ardhshme për të financuar hulumtimet. Kjo lëne në pikëpyetje ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë se si dhe kur kjo dobësi mund të jetë adresuar dhe nëse çështja në të vërtetë po merret seriozisht. Aktualisht Akademia nuk ka statistika mbi aktivitete e hulumtimit të stafit të tij akademik. Po ashtu ekipi i ekspertëve nuk ka identifikuar pjesëmarrjen e studentëve në proces të hulumtimit.

Akademia nuk ka një buxhet vjetor real dhe të qëndrueshëm për një institucion të arsimit të lartë. Përveç aktiviteteve të mësimdhënies dhe një pjesë për hulumtime asnjë veprimtari tjetër akademike nuk

përfaqësohet në buxhet, si shpenzime për: sigurimin e cilësisë, zhvillimit të stafit, hapësira specializuar dhe pajisjet ose internacionalizimi.

Programi i studimit: Dizajni Grafik & Multimedia

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar konstaton se deklarata e misionit është njëjtë për tri programe të studimit dhe është zhgënjyes që mund të përdoret për të përshkruar gati secilin program të Dizajnit Grafik & Multimedës kudo në botë. Nuk ka ndonjë artikullim të veçantë se çfarë një ndërmarrësi premtuese me LABA mund ti ofroj Kosovës. Nuk ka shpjegim se çka nënkupton me stil 'Italian dhe Evropian' dhe çka mund të rezultojë nga ajo që më herët është përmbledhë si çasje e "arteve të bukura" ku mbizotëron pasioni për estetikë dhe kreativitet.

Kodi etik i adaptuar me qëllim të themelimit të rregullave për sjellje profesionale për anëtarët e stafit akademik dhe administrativ, është shumë i përgjithshëm pa ndonjë mekanizëm specifik për të aplikuar sanksionet në rast të thyerjes së kodit. Për këtë nuk ka ndonjë dëshmi se institucioni është duke e aplikuar kodin dhe në kod nuk përmendet çështja e plagjiaturës. Kodi i adresohet stafit të Akademisë dhe jo studentëve si dhe nuk është i publikuar në ueb faqe të institucionit.

Nuk ka informata të mjaftueshme të publikuara për stafin akademik, hulumtim dhe aktivitete akademike, programe të ofruara, numri i studentëve të pranuar, rezultatet e synuara e të nxënies të programeve, kualifikimet që ata i japin, mësimdhënia, mësimnxënies dhe procedura të përdorura të vlerësimit, normat e kalueshmërisë dhe mundësitë e të nxënies në dispozicion të studentëve, informatat mbi punësim të diplomuarve, mundësitë e bursave, si dhe pagesat për shkollim dhe administratë.

Janë të paplotë dhe të pa evidentuara çështjet si: mbi atë që mund të ndodhë nëse një student dështon, nuk ka kufij të referimit, dallimin ndërmjet studimeve 'kryesore' dhe 'elementëve të studimit mbështetës për të mbrojtur integritetin e programit të studimit, vlerësimin e notimit, e drejta e ankesës, ankesat dhe zgjidhja e tyre. Nuk ka ndonjë referim ose doracak për studentët se ku mund ta gjejnë këto informatë.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë konstaton se ka keqkuptim të madh mbi konceptin e sigurimit të cilësisë ose kulturës së cilësisë brenda komunitetit akademik dhe stafit administrativ, madje edhe për ata që janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë në akademi.

Funksionet e sigurimit të cilësisë nuk janë të integruar në një cikël të përcaktuar të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe rishikimit. Analiza SWOT identifikon dobësi në përvojën e stafit në aplikim të teknologjisë bashkëkohore në programe dhe mungesa e resurseve për të filluar punën e re. Për të adresuar këto dobësi nuk është bërë alokimi buxhetor. Në statutin e institucionin ose në ndonjë rregullore të brendshme nuk ka dëshmi mbi vlerësimin periodik të stafit akademik, i vetmi instrument i aplikueshëm është pyetësori për studentë dhe diskutimi mbi rezultate, mirëpo rezultate e pyetësorit nuk përdoren për analizë publike dhe procesi nuk rezulton me ndonjë dokument.

Nuk ka asnjë përshkrim sa i përket rezultateve të mësimin, mbulueshmëris dhe vlerësimit. Nuk ka ndonjë rregullore të hollësishme lidhur me plagjiaturë ose forma të tjera të mashtrimit.

Rezultatet e përgjithshme vjetore të lëndëve nuk janë përpiluar në nivel institucional në raportin e përgjithshëm dhe nuk përdoren në analizën e rezultateve duke përfshirë trendët në kohë ose planet e veprimit.

Aktualisht institucioni nuk ka planë të zhvillimi për hulumtim, dhe se stafi duhet vetë të angazhohet në kërkime shkencore. Nuk ka ndonjë indikacion në planet e të ardhurave dhe shpenzimeve të Akademisë gjatë tre viteve të ardhshme për të financuar hulumtimet. Kjo lëne në pikëpyetje ekipin e ekspertëve ndërkombëtar se si dhe kur kjo do bësi mund të jetë adresuar dhe nëse çështja në të vërtetë po merret seriozisht. Aktualisht Akademia nuk ka statistika mbi aktivitete e hulumtimit të stafit të tij akademik. Po ashtu ekipi i ekspertëve nuk ka identifikuar pjesëmarrjen e studentëve në proces të hulumtimit.

Akademia nuk ka një buxhet vjetor real dhe të qëndrueshëm për një institucion të arsimit të lartë. Përveç aktiviteteve të mësimdhënies dhe një pjesë për hulumtime asnjë veprimtari tjetër akademike nuk përfaqësohet në buxhet, si shpenzime për: sigurimin e cilësisë, zhvillimit të stafit, hapësira specializuar dhe pajisjet ose internacionalizimi.

Programi i studimit: Fotografi, BA

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar konstaton se deklarata e misionit është njëjtë për tri programe të studimit dhe është zhgënjyes pasi që është i vetmi i këtij lloji në Kosovë.

Deklarata e misionit dhe objektivat mund të përdoren për të përshkruar gati secilin program të Fotografisë kudo në botë. Nuk ka ndonjë artikullim të veçantë se çfarë një ndërmarrësi premtues me LABA mund ti ofroj Kosovës.

Në pyetjen e nënkuptuar se pse një program i tillë mund të jetë veçanërisht i mirë për një brez të ri fotografësh në Kosovë nuk ka përgjigje. Pas dy vitesh operimi, nuk ka referencë në deklaratat të misionit apo në objektiva për atë se çka një program i nivelit të lartë në fotografinë përfaqëson në një botë të ndryshimeve të shpejta dixhitale, ku vetëm secili mund të marrë një fotografi të arsyeshme në telefonin e tyre celular.

Kodi etik i adaptuar me qëllim të themelimit të rregullave për sjellje profesionale për anëtarët e stafit akademik dhe administrativ, është shumë i përgjithshëm pa ndonjë mekanizëm specifik për të aplikuar sanksionet në rast të thyerjes së kodit. Për këtë nuk ka ndonjë dëshmi se institucioni është duke e aplikuar kodin dhe në kod nuk përmendet çështja e plagjiaturës. Kodi i adresohet stafit të Akademisë dhe jo studentëve si dhe nuk është i publikuar në ueb faqe të institucionit. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar nuk identifikuan ndonjë rregullore ose procedura relevante (si Strategjia, procedurat e QA, Kodi i Etikës etj.) në ueb faqen e internetit të akademisë.

Nuk ka informata të mjaftueshme të publikuara për stafin akademik, hulumtim dhe aktivitete akademike, programe të ofruara, numri i studentëve të pranuar, rezultatet e synuara e të nxënies të programeve, kualifikimet që ata i japin, mësimdhënia, mësimnxënies dhe procedura të përdorura të vlerësimit, normat e kalueshmërisë dhe mundësitë e të nxënies në dispozicion të studentëve, informatat mbi punësim të diplomuarve, mundësitë e bursave, si dhe pagesat për shkollim dhe administratë.

Janë të paplotë dhe të pa evidentuara çështjet si: mbi atë që mund të ndodhë nëse një student dështon, nuk ka kufij të referimit, dallimin ndërmjet studimeve 'kryesore' dhe 'elementëve të studimit mbështetës për të mbrojtur integritetin e programit të studimit, vlerësimin e notimit, e drejta e ankesës, ankesat dhe zgjidhja e tyre. Nuk ka ndonjë referim ose doracak për studentët se ku mund ta gjejnë këto informatë. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë konstaton se ka keqkuptim të madh mbi konceptin e sigurimit të cilësisë ose kulturës së cilësisë brenda komunitetit akademik dhe stafit administrativ, madje edhe për ata që janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë në akademi. Funksionet e sigurimit të cilësisë nuk janë të integruar në një cikël të përcaktuar të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe rishikimit.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë vënë në dukje mungesën e mësimi të nivelit të arsimit të lartë dhe strategji të mësimdhënies. Kultura e cilësisë dhe sistemet e sigurimit të cilësisë nuk janë të përfshira në proceset e institucionit. Analiza SWOT identifikon dobësi në përvojën e stafit në aplikim të teknologjisë bashkëkohore në programe dhe mungesa e resurseve për të filluar punën e re. Në statutin e institucionit ose në ndonjë rregullore të brendshme nuk ka dëshmi mbi vlerësimin periodik të stafit akademik, i vetmi instrument i aplikueshëm është pyetësi për studentë, mirëpo rezultate e pyetësorit nuk përdoren për analizë publike. Institucioni nuk ka zhvilluar politika/procedura që reflektoni në instrument për vlerësimin e secilën kategori të stafit.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar konstaton se përbërja e këtij program është teori me përmbajtje shumë të vogël të demonstrimit/praktikës, media e bazuar në lente dhe është zhgënjyese të shihet se në kurrikulë ka mbulueshmëri të vogël të praktikës.

Nuk ka referencë, për ndikim të madh në rritje nga Interneti (IoT, Industry 4.0), inteligjencës artificiale, kapjes së njohjes së modelit dhe zhvillimeve të tjera që lidhen me mediat me bazë lente.

Nuk ka asnjë përshkrim sa i përket rezultateve të mësimi, mbulueshmëris dhe vlerësimit. Nuk ka ndonjë rregullore të hollësishme lidhur me plagjiaturë ose forma të tjera të mashtrimit.

Rezultatet e përgjithshme vjetore të lëndëve nuk janë përpiluar në nivel institucional në raportin e përgjithshëm dhe nuk përdoren në analizën e rezultateve duke përfshirë trendët në kohë ose planet e veprimi. Aktualisht institucioni nuk ka planë të zhvillimi për hulumtim, dhe se stafi duhet vetë të angazhohet në kërkime shkencore.


Nuk ka ndonjë indikacion në planet e të ardhurave dhe shpenzimeve të Akademisë gjatë tre viteve të ardhshme për të financuar hulumtimet. Kjo lënë në pikëpyetje ekipin e ekspertëve ndërkombëtar se si dhe kur kjo dobësi mund të jetë adresuar dhe nëse çështja në të vërtetë po merret seriozisht. Aktualisht Akademia nuk ka statistika mbi aktivitete e hulumtimit të stafit të tij akademik. Po ashtu ekipi i ekspertëve nuk ka identifikuar pjesëmarrjen e studentëve në proces të hulumtimit.

Sa i përket bibliotekës insitucioni ka një sasi të vogël të materialit mësimor. Akademia nuk ka një buxhet vjetor real dhe të qëndrueshëm për një institucion të arsimit të lartë. Përveç aktiviteteve të mësimdhënies dhe një pjesë për hulumtime asnjë veprimtari tjetër akademike nuk përfaqësohet në buxhet, si shpenzime për: sigurimin e cilësisë, zhvillimit të stafit, hapësira specializuar dhe pajisjet ose internacionalizimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL, "Kosovo Art Academy"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë